

# Falja e namazit

për fillestarë

## Falja e akshamit

3 rekatë

Namazi i Akshamit ka 3 rekatë.

Së pari i fal dy rekatet e para njësoj si në namazin e sabahut deri në veprimin 6, pastaj duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e tretë.

### Rekati i tretë

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fattha** (si në veprimin 4). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin 5), mandej qëndron në uljen e **teshehudit** deri në **përfundim të namazit** (si në veprimet 6 dhe 7).

## Falja e drekës, ikindisë dhe jacisë

4 rekatë

Këto namaze kanë nga 4 rekatë.

Së pari i fal dy rekatet e para njësoj si në namazin e sabahut deri në veprimin 6, pastaj duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e tretë.

### Rekati i tretë

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fattha** (si në veprimin 2). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin 3), mandej duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e katërt.

### Rekati i katërt

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fattha** (si në veprimin 4). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin 5), mandej qëndron në uljen e **teshehudit** deri në **përfundim të namazit** (si në veprimet 6 dhe 7).

## Ajete kuranore për namazin

**Allahu i Madhërishtëm thotë:**

"Thuajju robërve të Mi, të cilët besojnë: Le të falin namazin..." (Kuran 14:31)

"Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!" (Kuran 20:14)

"Thuaj: "Udhëzimi i Allahut është i vetmi udhëzim i drejtë! Ne jemi të urdhëruar t'i nënshtrohemi Zotit të botëve, të falim namazin dhe ta kemi frikë Atë." Dhe është Ai, para të Cilit do të tuboheni." (Kuran 6:71-72)

"Dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..." (Kuran 29:45)

"Ata që u përbahen thënieve të Librit dhe që e kryejnë namazin, ta dinë se Ne, pa dyshim, nuk do t'ua humbim shpërbëtimin punëmirëve." (Kuran 7:170)

"Falenit rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij." (Kuran 2:238)

"Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, por përveçse për të përlulurit, që janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai." (Kuran 2:45-46)

"O besimtarë, kur të thirrini për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premtë, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtimin! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!" (Kuran 62:9)

"I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz! Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar." (Kuran 87:14-17)

"Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkim ty ndonjë ushqim (rizk); jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut." (Kuran 20:132)

## Thënie profetike për namazin

**I Dërguari i Allahut, Muhamedi (ﷺ) ka thënë:**

"Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): (1) të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, (2) faljen e namazit, (3) dhënien e zekatit, (4) haxhillëkun dhe (5) agjërimin e Ramazanit." (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

"Allahu ia ka bërë detyrë Vetes të fusë në Xhenet këdo që beson në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, që e fal namazin dhe e agjëron Ramazanin." (E shënojnë Buhariu)

"Gjëja e parë për të cilën robi do të merret në llogari Ditën e Gjykimit është namazi. Nëse atë e ka si duhet, çdo gjë tjetër do ta ketë në rregull. Mirëpo, nëse atë nuk e ka si duhet, as punët e tjera s'do t'i ketë në rregull." (E shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu)

I Dërguari i Allahut, Muhamedi (ﷺ) shokëve të vet u kishte thënë:

"Çka mendoni, sikur para derës së ndonjërit prej jush të ishte një lumë, ku ai do të lahej pesë herë në ditë, a do t'i mbetej ndonjë ndrysi në trup?" Ata thanë: "Nuk do të mbetej as edhe një ndrysi e vetme." Atëherë i Dërguari (ﷺ) u tha: "Kjo u shëmbëllen pesë kohëve të namazit, me të cilat Allahu i pastron mëkatet." (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

"Allahu i Madhërishtëm ka thënë: "Unë ia kam bërë detyrë umerit tënd pesë namaze dhe kam dhënë besën se, kushdo që i ruan ato, duke i falur në kohën e tyre, do ta fus në Xhenet, kurse për atë që nuk i ruan ato, nuk kam dhënë besë." (E shënojnë Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe)

"Ajo që na dallon ne nga ata (jobesimtarët) është namazi. Andaj, ai që e lë namazin, ka rënë në kufër (mosbesim)." (E shënojnë Ahmedi, Tirmidhiu, Nesaiu, Ibn Hilbani dhe Hakimi)

Abdullah ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me tëi, ka thënë:

"E kam pyetur të Dërguarin e Allahut (ﷺ) se cila është vepra më e dashur tek Allahu i Lartësuar? Ai më është përgjigjur: "Namazi në kohën e vet." (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

Amaneti i fundit i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) në prag të vdekjes ishte: "Namazin, namazin dhe ata që i keni nën sundim!" (E shënojnë Ahmedi dhe Ibn Maxhe)



Forma e faljes së namazit - VIDEO

Përshkrim i detajuar nga abdesi deri te salam  
www.iftamusliman.com/namaz

### 1 SABAHU

Sabahu (fexhër) falet në agim, nga koha kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit dhe vazhdon deri para lindjes së diellit.

### 4 AKSHAMI

Akshami (magrib) fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit.

### 2 DREKA

Dreka (dhuher) falet pasi të lëvizë dielli prej zenitit deri në pozitën kur hija e një objekti arrin gjatësinë e atij objekti.

### 5 JACIA

Jacia (isha) falet pasi të errësohet plotësisht horizonti dhe zgjat deri para agimit.

### 3 IKINDIA

Ikindia (asër) falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri para perëndimit të diellit.

### VITRI

Namazi i vitrit falet pas namazit të jacisë. Nuk është mirë të lihet pa falur, edhe pse nuk është farz. Muhamedi (ﷺ) gjithmonë e ka falur namazin e vitrit.

## TABELA E REKATEVE

Namazi përbëhet nga pjesët e quajtura rekatë

Namazi	Sunet (para)	Farz	Sunet (pas)
Sabahu	2	2	
Dreka	4	4	2
Ikindia	4	4	
Akshami		3	2
Jacia		4	2

Vitri 3

## ABDESI

Para se të fillojmë faljen e namazit, duhet të marrim abdes.

Abdesi është kusht për faljen e namazit!



1

Thuaj Bismillah dhe laj duart deri në kyçe



2

Shpëlaj gojën 3 herë



3

Shpëlaj hundën 3 herë




4

Laj fytyrën 3 herë



5

Laj dorën e djathtë deri mbi bërryl, pastaj edhe të majtën, nga 3 herë



6

Me duar të lagura fërko kokën



7

Me duar të lagura fërko veshët



8

Laj këmbën e djathtë pastaj të majtën deri mbi kyçe

# Falja e Sabahut

2 rekate


## 1 FILLIMI I NAMAZIT



Qëndro në këmbë, drejtohu nga kibra,  
ngriji duart dhe thuaj

## Allahu Ekber

## 2 REKATI I PARË



Vendos dorën e djathtë mbi të majtën dhe thuaj

Subhanek'Allahumme, ve bihamdike,  
ve tebareke'smuke, ve teala xhedduke,  
ve la ilahe gajruke.

Eudhu bil-lahi mineshejtanirr-rraxhim

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim  
Elhamdu lili-lahi Rabil-alemin  
Err-Rrahmanirr-Rrahim, Maliki jevmid-din  
ijjake na'budu ve ijjake neste'in  
ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine  
en'amte 'alejhim gajril-magdubi 'alejhim  
ve led-daalin. AMIN

FATHA

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim  
Inna e'atajnake-kevther.  
Fesal-li, li rabbike venhar.  
inne shanieke huvel-ebter.

KEVTHER

## 3 RUKU DHE SEXHDE

Allahu Ekber  
Subhane  
Rabijel-Adhim

3 herë



Semi'Allahu  
limen hamideh  
Rabbena  
ve lekel-hamd

3 herë



Allahu Ekber  
Subhane  
Rabijel-'Ala

3 herë



Allahu Ekber  
Rabbi'gfir li,  
Rabbi'gfir li

3 herë



Allahu Ekber  
Subhane  
Rabiel 'la

3 herë



## 4 REKATI IDYTË



ngrihu në këmbë duke thënë

## Allahu Ekber

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim  
Elhamdu lili-lahi Rabil-alemin  
Err-Rrahmanirr-Rrahim, Maliki jevmid-din  
ijjake na'budu ve ijjake neste'in  
ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine  
en'amte 'alejhim gajril-magdubi 'alejhim  
ve led-daalin. AMIN


FATHA

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim  
Kul huvAllahu Ehad. Allahus-Samed.  
Lem jelid, ve lem juuled.  
ve lem jekun lehu kufuven ehad.

IHLAS

## 5 RUKU DHE SEXHDE

vepromi si në figurat nr. 3



## 6 TESHEHUDI



## Allahu Ekber

qëndro ulur

Et-Tehijjatu il-lahi, ves-salavatu, vet-tajjibatu.  
Es-selamu 'alejke ejuhen-nebiju ve rahmetullahi  
ve berekatuhu. Es-selamu 'alejna ve 'ala 'ibadiil-lahis-salihin.

Eshhedu en la ilahe il-Allah ve eshedu  
enne Muhammeden 'abduhu ve resuluhu.

## 7 PËRFUNDIMI I NAMAZIT

qëndro ulur

Allahumme sal-li 'ala Muhammedin  
ve 'ala ali Muhammed, kema sal-lejte 'ala Ibrahim,  
ve 'ala ali Ibrahim, inneke Hamidun Mexhid.

Allahumme barik 'ala Muhammedin  
ve 'ala ali Muhammed, kema barekte 'ala Ibrahim,  
ve 'ala ali Ibrahim, inneke Hamidun Mexhid.

Allahumme Rabbena atina fid-dunja haseneten,  
ve fil-ahireti haseneten ve kina 'adhaben-nar.  
Rabbena'gfir li ve li validejje ve lil-mu'minine  
jevme jekumul-hisab.

SALVATET

Es-selamu 'alejku  
ve rahmetullah

ktheje kokën  
në anën e djathtë



Es-selamu 'alejku  
ve rahmetullah

pastaj ktheje kokën  
në anën e majtë

